



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:001071

Datë: 12.10.2020

Numri i dokumentit: 01213173

C.nr.38/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësve Sh.H.A. nga Ferizaj, S.B.H. nga Ferizaj, B.D. nga Ferizaj, të cilët i përfaqëson me autorizim av.Arian Hetemi nga Lipjani, kundër të paditurës Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë-Agjencia për Aftësimin profesional dhe Arsim për të rritur në Prishtinë të cilën e përfaqëson me autorizim Bedri Krasniqi avokat shtetëror, në çështjen juridike kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, në seancën e mbajtur me datë 16.09.2020, mori ndërsa me datë 12 tetor 2020 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve, Sh.H.A. nga Ferizaj, S.B.H. nga Ferizaj, B.D. nga Ferizaj nga Ferizaj, si e bazuar, ashtu që DETYROHET e paditura Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë-Agjencia për Aftësimin profesional dhe Arsim për të rritur në Prishtinë që paditësve në emër të pagave jubilarë dhe në emër të shpenzimeve të ushqimit (për periudhën kohore 18 prill 2017 deri më 11 mars 2020) t'u kompensoj shumat si në vijim:

-Paditëses Sh.H.A. nga Ferizaj shumën e përgjithshme prej 1,014 € në emër të shpenzimeve të ushqimit për 507 ditë pune.

-Paditësit S.B.H. nga Ferizaj, shumën e përgjithshme prej 1,364 €, në emër të shpenzimeve të ushqimit për 682 ditë pune.

-Paditësit B.D. nga Ferizaj shumën e përgjithshme prej 1,456 €, në emër të shpenzimeve të ushqimit për 728 ditë pune.

II.DETYROHET e paditura që shumat e përcaktuara sikurse në pikën II të dispozitivit t'ua paguaj paditësve secilit veç e veç me kamat ligjore prej 8 % nga data 06.01.2020, deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 1,142.50 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

III. REFUZOHET kërkesa e paditësve për shpenzime të procedurës përtej shumës së aprovuar në pikën III të dispozitivit, si e pa bazuar.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësve av.Arian Hetemi ka paraqitur padi në gjykatë dhe në seancën e mbajtur me 16 shtator 2020 ka propozuar që të bëhet nxjerrja e provës me ekspertizë financiare për përllogaritjen e lartësisë së kompensimeve përmes kësaj ekspertize dhe propozimin e ka arsyetuar me faktin se për llogaritjen e këtyre shpenzimeve është e nevojshme përllogaritja profesionale dhe duhet pasur njohuri të veçanta në fushën financiare për të konstatuar saktë shpenzimet e ushqimit si dhe nxjerrjen e kamatës ligjore deri në pagesën definitive.

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paditësve, për faktin se padia bazohet në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 17 prill 2017 si dhe provat e bashkangjitura, duke i propozuar gjykatës që ta aprovon kërkesëpadinë e paditësve, dhe ta detyroj të paditurën që paditësve tu paguaj në emër të kompenzimit të shpenzimeve ushqimit shumat e lartcekura, përkatësisht nga data 18.04.2017 deri në vendosje, me kamatë 8 % prej datës 06.01.2020 kur e paditura ka ra në vonës e deri në pagesën definitive.

I autorizuari i paditësve ka kërkuar shpenzimet e krijuara gjatë kësaj procedure gjyqësore, dhe atë për përpilim të padisë për 5 paditës 312 euro, për tri seanca gjyqësore nga 405 euro dhe për taksë gjyqësore 20 euro, pra shumen totale në vlerë prej 1.547euro.

I autorizuari i paditësve av. Arian Hetemi gjatë seancës përgatitore, i ka propozuar gjykatës që të bëhet nxjerrja e provës me ekspertizë financiare, për të bërë kalkulimin e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për shkak se për çështje të ndërlikuara sipas LPK-së për këto çështje parashihet ekspertizë prej fushës përkatëse.

I autorizuari i të paditurës ka qenë prezent në seancën e mbajtur me datë 16.09.2020 dhe i njëjti ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve dhe se mbetet pranë pretendimeve si në përgjigje në padi si dhe deklarimeve të seancës 03.09.2020 ku i njëjti në atë seance ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar duke vlerësuar se paditësit kanë lidhur kontrata pune me të paditurën, e që orari i punës është 20 orë në javë e që në bazë të ligjit të punës orari i plotë i punës zgjatë 40 orë në javë e si rrjedhojë e kësaj paditësit nuk e gëzojnë të drejtën e shujtës me arsyetimin se nuk kryejnë 8 orë pune në ditë.

Kurse sa i përket paditësve e paditura nuk e ka kontestuar faktit se paditësit kanë qenë në marrëdhënie pune të rregullt me paditësin, por ka theksuar që kërkesëpadia është e pabazuar dhe kanë kërkuar nga gjykata që ta hudhë si të palejuar për shkak të mos shërjes së mjeteve juridike të brendshme brenda institucionit të së paditurës. Përfaqësuesi i palës së paditurës ka kundërshtuar propozimin e të autorizuarit të paditësve për nxjerrjen e ekspertizës financiare.

Lidhur me këtë gjykata ka caktuar seancën gjyqësore më 03.09.2020, në të cilën përveç tjerash ka marrë aktvendim procedural, me të cilin është refuzuar propozimi i të autorizuarit të paditësve, për nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare. Po ashtu gjykata ka vendosur që të obligohen paditësit që brenda afatit prej 7 (shtatë) dite të bëjnë precizimin e lartësisë së kërkesëpadisë.

I autorizuari i paditësve brenda afatit të dhëna nga gjykata me parashtresën e datës 07.09.2020 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë për secilin paditës.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve ka bërë administrimin e provave si vijojnë: padia C.nr.38/20 e datës 06.01.2020, vërtetimet nga e paditura nr.84/19 dt.17.12.2019, v kontrata e punës leshuar në emër të paditësit Sh.H.A., kontrata e punës leshuar në emër të paditësit S.H., kontrata e punës leshuar në emër të paditësin B.D., përgjigje në padi e dt.21.05.2020, parashtresë për precizim të padisë e datës 07.09.2020, vërtetime nga e paditura lidhur me numrin e ditëve në punë të paditësve.

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk ishte kontestuese në mesë palëve ndërgjyqjese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe nga data 18.04.2017 kur dhe ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 12.03.2020, kanë qenë në vendin e punës, respektivisht është vërtetuar prezenca e tyre në vendin e punës në ditët e precizuara për secilin veç e veç, nuk ishte kontestuese edhe lartësia e kërkesëpadisë por kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë se a u takojnë paditësve shumat e kërkuara.

Gjykata përmes kontratave të punës të cilat janë administruara ka vërtetuar faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura.

Gjykata me leximin e listës –vërtetimit për ditët në punë dhe përvojën e punët të paditësve lëshuar nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional –Qendra e Kompetencës në Ferizaj ka vërtetuar faktin e ditëve të pranisë së paditësve në vendin e punës nga data 18.04.2017, kur ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 12.03.2020, dhe atë paditësja Sh.H.A. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 507 ditë, paditësi S.B.H. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 682 ditë, B.D. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 728 ditë.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësit e kanë shfrytëzuar një të drejtë pasi që të njëjtit përfitojnë nga kjo kontratë për faktin se për periudhën nga data 18.04.2017 deri me datën 12.03.2020, kanë qenë në vendin e punës respektivisht prezenca e tyre në vendin e punës i cili fakt është vërtetuar përmes listës –vërtetimeve të ditëve të punës të lëshuar nga Ministria e arsimit shkencës dhe teknologjisë, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional-nga Drejtoria e shkollës Qendra e Kompetencës, andaj sipas nenit 35 par.7 është paraparë që të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë, për një ditë pune është 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, andaj gjykata sa i përket aprovimit të lartësisë kërkesëpadisë në lidhje me ushqimin e ka bazuar duke e llogaritur ditët e pranisë në punë të secilit paditës e duke e shumëzuar me 2 euro për secilën ditë të pranisë së tyre në vendin e punës.

Andaj duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratës Kolektive, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditësve është e bazuar ku dhe e ka detyruar të paditurën që paditësve secilit veç e veç tua paguaj shumat e specifikuara në pikën II të dispozitivit, në njërën anë kurse në anën tjetër e paditura nuk e ka përmbushur obligimin siç e ka pasur për detyrim sipas Kontratës Kolektive e datës 18.04.2017, sa i përket mjeteve monetare për ushqim të specifikuara për secilin paditës veç e veç sikurse në pikën II të dispozitivit.

Sa i pretendimit të përfaqësuesit të paditurës se kërkesëpadia e paditësve duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka mjete financiare që ti përmbushë këto detyrime ndaj paditësve, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate të gjitha institucionet e arsimit të lart, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin me kohë për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësit.

Sa i dhe sa i përket pretendimeve të paditurës se kërkesëpadia e paditësve duhet të refuzohet për faktin se sipas nenit 20 të Ligjit të Punës orari i punës është 40 orë në javë, kurse paditësit nuk e kanë këtë numër të orëve në vendin e punës gjykata konsideron se një pretendim i tillë nuk qëndron pasi organizimi procesit mësimor në territorin e Republikës së Kosovës është i rregulluar në atë formë duke pasur parasysh specifikat e rastit konkret, andaj dhe orari i procesit mësimor që mbajnë mësimdhënësit konsiderohet orar i plotë i punës, pasi që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore.

Vendimin për kamatëvonesë, gjykata ka vendosur që të llogaritet nga dita e marrjes së këtij aktgjykimin deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata duke u bazuar në nenin 452 par 1 të LPK-së e ka obliguar të paditurën që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 1,142.50 € (njëmijë e njëqind e katërdhjetë euro) dhe atë për përpilim të padisë shumë prej 312€, për përfaqësim në dy seanca shumë prej 810euro, për taksën gjyqësore për padi 20€, në ndërlidhje me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve në fuqi.

.

Ndërsa gjykata e ka refuzuar kërkesën për shpenzime të procedurës, përtej shumës së aprovuar, si të pa bazuar, sepse nga arsyet e lartë cekura, gjykata që në fillim të këtij shqyrtimi i është referuar dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me thjeshtëzimin e procedurës, pasi çdo seancë gjyqësore e mbajtur, nuk nënkupton apriori që kërkesa për shpenzime të procedurës duhet të aprovuar me bindjen e suksesit të gjykimit të çështjes kryesore, ngase duhet vlerësuar edhe aspekti i “kontributit” që kanë krijuar shpenzime. Në këtë kuptim dispozita e nenit 450 të LPK-së, ka përcaktuar *“Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet e veta procedurale”*. Andaj gjykata nuk ka llogaritur shpenzimet për përfaqësim në seancën e datës 03.09.2020 pasi seanca ka qenë e shtyrë sipas propozimeve të autorizuarit të paditësve që kanë qenë arsye e refuzimit të kërkesë për shpenzime, përtej kërkesës së aprovuar.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.38/20 datë 12 tetor 2020

Gjyqtarja

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.